



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 108 Datë 26.06.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“BESTA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “KUCOVA 2” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 MW.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10, pikat 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurën e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Besta” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Kucova 2” me kapacitet të instaluar 2 MW, të kësaj shoqërie.

Konstatohet se:

Shoqëria “Besta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 394 Prot., datë 10.06.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Kucova 2” me kapacitet të instaluar 2 MW.

Shoqëria “Besta” sh.p.k. ka depozituar në ERE shkresat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 8643 Prot., datë 14.06.2018 dhe nr. 8643/2 Prot., datë 17.08.2018, nga e cila rezulton se kjo e fundit, ka aplikuar pranë kësaj ministrie për pajisje me “Miratim Paraparak”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresat sipërcituar, i drejtohet shoqërisë “BESTA” sh.p.k duke i komunikuar se pranon aplikimin e saj për pajisjen me Miratim Paraparak në zbatim të VKM-së nr. 822, datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar.

Aplikimi i shoqërisë “Besta” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- **Formati i aplikimit** (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë pjesërisht.;
- **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- **Dokumentacioni teknik** (neni 9, pika 4.4.3, gërma “c”; pika 4.4.4 gërmat “d”) është plotësuar në pjesërisht..

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Neni 9, pika 2, gërma “f” Marrëveshje Koncesioni ose autorizimi nga KM në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës; gërma “g” dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).
- Neni 9, pika 4.4.1 Të dhënat teknike për centralet Fotovoltaik.
- Neni 9, pika 4.4.2 Të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.
- Neni 9, pika 4.4.3 Dokumentacioni teknik dhe grafik, **gërma “a”** Paraqitje e përgjithshme skematike të centralit A1; **gërma “b”** Një diagramë elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohet qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes; **gërma “d”** Një hartë topografike ku të paraqitet qartë gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1:25000.
- Neni 9, pika 4.4.4 Dokumentacioni tekniko- ekonomik, **gërma “a”** Studimi i fisibilitetit teknik; **gërma “b”** Grafiku i zbatimit të projektit; **gërma “c”** Oponenca teknike e projektit.
- Neni 9, pika 4.4.5 Leje nga institucione të tjera, gërma “a” Miratimin e OST ose OSSH-s për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërdarjes; gërma “b” Leje mjedisore nga organet përkatëse;

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, t’u paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Besta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Kucova 2” me kapacitet të instaluar 2MW, për një afat 20 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI